

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 68393/17

David GJOKEJA
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 19 shtator 2023, si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 68393/17) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa"), më 12 shtator 2017 nga shtetasi shqiptar z. David Gjokeja, i lindur në vitin 1967 dhe i burgosur në Peqin ("kërkuesi") i përfaqësuar nga z. N. Pjetra, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar nga agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimimet në lidhje me drejtësinë e procesit penal kundër kërkuesit dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

60. Kërkesa ka të bëjë dhe gjykimin dhe dënimin e kërkuesit *in absentia* për vrasje në vitin 2006.

61. Në proceset gjyqësore ku ai u dënua me burgim të përjetshëm, kërkuesi u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur nga familja e tij. Në vitin 2016, kërkuesi u arrestua gjatë kalimit të kufirit shqiptar me Greqinë dhe u vu në dijeni për dënimin e tij. Më pas kërkuesi depozitoi kërkesën për rivendosje në afat përpara gjykatës së brendshme në lidhje me gjykimin dhe dënimin e tij *in absentia*.

62. Në vitin 2017, ndërsa kërkesa e tij për rivendosje në afat ishte akoma në pritje përpara Gjykatës së Lartë, kërkuesi depozitoi një ankim në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me gjykimin e tij *in absentia*. Ai u bazua në praktikën e mëparshme gjyqësore të Gjykatës që e lejonte këtë ankim kushtetues në rrethana të ngjashme. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin me arsyetimin që kërkuesi nuk i kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore sepse kërkesa e tij për rivendosje në afat ishte akoma në pritje përpara Gjykatës së Lartë, prandaj nuk plotësoheshin kërkesat dhe kriteret ligjore për vlerësim nga Gjykata Kushtetuese.

63. Më 22 shtator 2022, përpara se kërkesa t'i komunikohet palëve, Gjykata i dërgoi kërkuesit një shkresë ku e pyeste nëse kishte ndonjë zhvillim të ri në çështjen e tij, sidomos në lidhje me procesin përpara Gjykatës së Lartë që ishte në pritje në momentin e kërkesës. Më 22 tetor 2022, kërkuesi nëpërmjet përfaqësuesit të tij, mohoi çdo zhvillim të tillë, sidomos përpara Gjykatës së Lartë.

64. Kërkuesi ankohet sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës për gjykimin dhe dënimin e tij *in absentia*.

VLERËSIMI I GJYKATËS

65. Qeveria u shpreh, mes të tjerave, që kërkesa duhet të refuzohet si abuzim i të drejtës së një kërkesë individuale sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës, sepse kërkuesi nuk e kishte informuar Gjykatën për zhvillimet gjyqësore të filluara prej tij që ndodhën përpara dhe pas depozitimit të kërkesës në Gjykatë. Në veçanti, Qeveria i referohet dhe paraqet kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 875 të datës 9 nëntor 2017 në lidhje me kërkesën e kërkuesit për rivendosje në afat dhe kërkesave të tij për rishikimin e vendimit të dënimit të depozituara përpara gjykatave të brendshme në periudhën 7 gusht 2017 dhe 29 mars 2018. Në parashtrimet e tij, kërkuesi i pranon këto zhvillime, por nuk jep shpjegime për informacionin që mungon në lidhje me ato.

66. Gjykata ka përsëritur që paraqitja e informacionit të paplotë dhe për rrjedhojë keqorientues mund të përbëjë abuzim të së drejtës për kërkesë, sidomos nëse informacioni ka të bëjë me vetë thelbin e çështjes dhe nuk është dhënë shpjegim i mjaftueshëm për mosdhënien e këtij informacioni. E njëjta gjë vlen nëse zhvillime të reja të rëndësishme kanë ndodhur gjatë proceseve përpara Gjykatës dhe ku, pavarësisht nëse kërkohet shprehimisht që të veprohet kështu sipas Rregullit 47 § 7 (ish-Rregulli 47 § 6) të Rregullores së Gjykatës, kërkuesi nuk i ka dhënë informacion Gjykatës, duke e penguar në këtë mënyrë vendimmarrjen në lidhje me çështjen me dijeni të plotë të fakteve (shihni *çështja Gross kundër Zvicrës* [GC], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014).

67. Që në fillim Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka informuar Gjykatën për zhvillimet që kanë ndodhur pas dorëzimit të kërkesës së tij përpara Gjykatës (shihni paragrafin 4 më sipër).

68. Megjithatë, siç parashtrohet nga Qeveria, dhe siç pranohet nga kërkuesi në parashtrimet e tij, Gjykata e Lartë në fakt kishte nxjerrë një vendim për çështjen e kërkuesit më 9 nëntor 2017, pra pothuajse dy muaj pas depozitimit të kërkesës në Gjykatë, ku refuzonte kërkesën për rivendosje në afat. Gjithashtu, duket se kërkuesi gjithashtu kishte filluar proces gjyqësor për rishikimin e vendimit të dënimit më 7 gusht 2017. Këto procese, që kanë lidhje drejtpërdrejt me çështjen e kërkuesit përpara Gjykatës, ishin fshehur prej tij.

69. Siç vërehet më sipër, sipas Rregullit 47 § 7 të Rregullores së Gjykatës kërkuesit kanë detyrimin të informojnë Gjykatën për të gjitha rrethanat në lidhje me kërkesën. Edhe pse kërkuesit nuk pritet që të paraqesin të gjithë informacionin e mundshëm për një çështje në kërkesën e tyre, ata kanë për detyrë, të paktën, të paraqesin fakte thelbësore në dispozicion të tyre që janë qartazi me rëndësi thelbësore për Gjykatën që të vlerësojë çështjen si duhet. Megjithatë, në këtë çështje, kërkuesi nuk e përmbushi këtë detyrim. Në këtë situatë, Gjykata gjen elementë të mjaftueshëm për të vendosur që kërkuesi, duke mos përmbushur detyrimin e tij sipas Rregullit 47 § 7 të Rregullores së Gjykatës, me dashje pengoi Gjykatën për të mos pasur njohuri të plotë të fakteve të çështjes që kanë të bëjnë me vetë thelbin e objektit të ankimit të tij sipas Konventës (shihni *çështja Gross*, §§ 35-37, cituar më sipër, dhe *çështja Gevorgyan dhe të tjerët kundër Armenisë* (dec.), nr. 66535/10, §§ 31-37, 14 janar 2020). Kërkuesi nuk dha ndonjë sqarim në lidhje me arsyet pse ka vepruar kështu.

70. Bazuar në sa më sipër, Gjykata pranon kundërshtimin paraprak të Qeverisë që sjellja e kërkuesit përbënte abuzim të së drejtës për ankimim individual sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës.

71. Për rrjedhojë, kjo pjesë e kërkesës duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35, paragrafi 4, të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim, më 12 tetor 2023.

Olga Chernishova
Zëvendëskancelare

Georgios A. Serghides
President

